



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. 2-D  
 Nr. llog. \_\_\_\_\_  
 Broj stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages \_\_\_\_\_

Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
 B. Prot. \_\_\_\_\_  
 Prot. No. 01-444/16  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum \_\_\_\_\_  
 Date 04-02-2016



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.02.2016 mori:

**V E N D I M**

- I. **Ekziston konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik** në rastin me nr. AKK -03-4297/15, për znj. Nadire Hoxha – Këshilltare Komunale në Kuvendin e Komunës së Therandës dhe njëkohësisht avokate e regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës.
- II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e saj.
- III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

**A r s y e t i m**

- I. Rasti për zyrtaren e lartë Nadire Hoxha, e cila ushtron funksionin publik të Këshilltares Komunale në Kuvendin Komunal të Therandës dhe njëkohësisht është avokate e regjistruar në Odën Avokatëve të Kosovës, është incizuar zyrtarisht nga Agjencia kundër Korrupsionit.

Fillimisht zyrtarja e lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, znj. Hoxha është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së dhe është njoftuar me faktet që posedon Agjencia, në lidhje me situatën e konfliktit të interesit.

Zyrtares së lartë znj. Hoxha i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtare e lartë, nuk mund të ushtroj detyrën e avokates. Kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) e ndalon një gjë të tillë.

Neni 16 (pika 2) e këtij ligji shprehimisht përcakton:

*“Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni”.*

Bazuar në këtë dispozitë, Agjencia, përmes shkresës paralajmëruese, e ka njoftuar znj. Hoxha, se nuk mund të ushtroj këto dy funksione njëkohësisht dhe se duhet të zgjedhë njërin prej tyre. Për shmangien e konfliktit të interesit Agjencia i ka dhënë një afat të ri, por të kufizuar ligjor, për ta ndryshuar këtë gjendje, duke shmangur konfliktin e interesit. Mirëpo, znj. Hoxha nuk e ka përfillur këtë afat dhe nuk ka ndërmarr asnjë veprim për t’u larguar nga njëri prej funksioneve.

II. Agjencia, bazuar në nenin 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit, do të kërkoj nga Ministria e Pushtetit Lokal që të filloj procedurën për shkarkimin e saj. Pika 8 e këtij neni përcakton se *“në rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij”.*

III. Sipas nenit 20 (pika 1) të këtij ligji, *“çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuar në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3”.*

Sipas pikës 2 të këtij neni, *“për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund t’i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.*

IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë (neni 18 pika 12).

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

